

Për një miqësi të mirë

Këmbimi i parë i nxënësve kosovaro-gjerman

Në vend se t'i kalojnë pushimet e tyre të vjeshtës në shtëpi, 19 nxënës gjermanë të Gjinnazit Thomas-Morus (TMG) nga qyteti Oelde, nga fundi i muajit shtator vendosën që të vizitojnë Gjinnazin Loyola (ALG) në Prizren.

Nxënësit u treguan të ngazëllyer nga mikpritësit e tyre. „Njerëzit këtu janë shumë të hapur, të pakomplikuar dhe të hareshëm”, rrëfen Pauline. Nxënësja 13-vjeçare e gjinnazit TMG sqaron me plot krenari gjithçka që ka përjetuar në Kosovë: „Kemi përcjellë mësimin në gjuhën gjermane të nxënësve kosovarë dhe kemi shkuar në Prishtinë dhe në Prizren.” Për nxënësin e ALG-së, Arianin, kjo javë kaloi me plot sukses: „Ne kemi punuar në projekte shumë interesante artistike.

Pikat kulmore, megjithatë ishin ndejat në mbrëmje.” Erich Merz, mësues në TMG dhe bashkëiniciator i këtij këmbimi me qëllim ka vendosur për lëmin e artit si temë projekti: „Arti mund t'i bashkojë njerëzit edhe pa një nivel të lartë të njohurisë së gjuhës së përbashkët.” Bashkrisht nxënësit krijuan një vizatim grafiti me inicialet e shkollave të tyre. Walter Happel, prifti jezuit dhe rektor i ALG-së, është i

gëzuar që nga një trajnim i mësuesve të tij të gjermanishtes në TMG, rezultoi ky këmbim. „Nxënësit tanë kosovarë vetëm nuk kanë marrë, por ata edhe kanë dhënë shumë. Kjo thjesht është një ndjenjë e bukur!” Partneriteti ndërmjet këtyre dy shkollave nuk do të jetë një rrugë njëkahëshe. Që tani është planifikuar një kthim vizite për vitin e ardhshëm në Oelde. (thb)



Fotografi grupore para veprës së artit të punuar së bashku

[foto: thb]